



RAPORTI VJETOR

Viti Akademik, 2019-2020

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Kolegji Universitar “Wisdom”

Tabela e Përmbajtjes

<i>Shkurtime</i>	2
I. Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë në Kolegjin Universitar "Wisdom"	3
<i>a. Sigurimi i brendshëm i cilësisë</i>	3
<i>b. Sigurimi i jashtëm i cilësisë</i>	3
II. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, (NjSBC) Funkzionet dhe përbërja	4
III. Plani vjetor i punës së NjSBC gjatë vitit akademik 2019-2020	7
IV. Realizimet dhe veprimtaria e NjSBC viti akademik 2019-2020	13
a. Vlerësim i politikave dhe qëllimi i sigurimit të cilësisë në IAL	13
b. Mekanizmat e sigurimit të cilësisë në IAL dhe rezultatet e gjetjeve	17
c. Të dhëna mbi vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë së studentëve dhe vlerësimin e tyre sipas programeve të studimit.	29
d. Vlerësimi dhe të dhëna mbi ecurinë e punës kërkimore shkencore të personelit akademik sipas Fakulteteve	33
V. Vlerësime të institucionit mbi sigurimin e cilësisë dhe rekomandime	49

Shkurtime

KUW	Kolegji Universitar “WISDOM”
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
SBSC	Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë
ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë
IAL	Institucioni i Arsimit të Lartë
IKZHW	Instituti për Kërkim dhe Zhvillim “Wisdom”
MASR	Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë
NJKSH&MJ	Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë
ZBNjKK&JS	Zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore

I. Sigurimi i Brendshëm dhe i Jashtëm i Cilësisë në Kolegjin Universitar “Wisdom”

a. Sigurimi i brendshëm i cilësisë¹

Bazuar në Statutin e Kolegjit Universitar “Wisdom”, (në vazhdim K UW) sigurimi i brendshëm i cilësisë në K UW është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare në IAL. Ky vlerësim kryhet të paktën 1 (një) herë në 6 (gjashtë) vjet, por gjithashtu mund të kryhet sa herë shihet e arsyeshme, si vlerësim i përgjithshëm ose i pjesshëm. Sigurimi i brendshëm i cilësisë në K UW realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet:

- a) Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të K UW, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij.
- b) Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), e cila vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të K UW dhe harton raportin përkatës të Vlerësimit të Brendshëm. Ky raport diskutohet në të gjitha njësitë e K UW, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.

b. Sigurimi i jashtëm i cilësisë²

Sigurimi i jashtëm i cilësisë së K UW, kryhet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) ose agjenci të tjera të autorizuara, me kërkesë të rektorit të institucionit, pas përfundimit të raportit të vlerësimit të brendshëm.

¹ Statuti i K UW, Neni 11 “Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë”.

² Po aty.

II. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Funkcionet dhe përbërja.

Ngritja dhe funksionimi i NjSBC, në KUW, mbështetet në nenin 103 të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në aktet nënligjore në zbatim të ligjit si dhe në Statutin e KUW, Neni 27, Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë. NjSBC në KUW është një strukturë autonome, e përhershme e KUW.

Bazuar në Statut, përbërja e kësaj njësie është: 5 anëtarë, të cilët përfaqësojnë njësitë kryesore të KUW, këshillin e studentëve, mund të bëjë pjesë dhe 1(një) anëtar në cilësinë e ekspertit të jashtëm³. Anëtarët e NjSBC emërohen nga Senati Akademik, nga radhët e personelit akademik, sipas propozimeve të bëra nga njësitë kryesore. Kryetari emërohet nga Rektori i KUW.

NjSBC vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore, harton relacione dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë. Njësia ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Ajo organizon punën në bashkëpunim me njësitë bazë, Komisionin për garantimin e standarteve të cilësisë, për kontrollin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë sipas standartëve shtetërore të cilësisë, si dhe duke respektuar lirinë akademike në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies.

Në fillim të çdo viti akademik, NjSBC harton planin e veprimtarisë së saj në funksion ruajtjes dhe zhvillimit të procesit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. NjSBC, përgatit raportet vjetore periodike për procesin mësimor dhe adreson rekomandime. Organizimi dhe funksionimi i NjSBC dhe i SBSC në Kolegjin Universitar përcaktohen në rregulloren e saj.

Fushat e veprimit të NjSBC në KUW janë:

³ Statuti i KUW, Neni 27 “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”

- Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë;
- Subjektet e sigurimit të cilësisë;
- Cilësia në programet studimore;
- Efikasiteti i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe praktikat profesionale;
- Proçesi i kontrollit të dijeve;
- Burimet njerëzore, stafi dhe siguri i cilësisë;
- Studentët e KUW;
- Proçesi i diplomimit;
- Veprimtaria administrative dhe financiare në kolegji;
- Biblioteka, tekstet, literatura e disponuar dhe laboratorët në universitet;
- Përkrahja në veprimtaritë jashtë-mësimore;
- Ambienti, hapësira në dispozicion dhe pajisjet;
- Përfshirja e studentëve në proçesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë.

Të dhëna për anëtarët e NjBSC

Tabela 1

	Anëtarët e NjBSC	Detyra që kanë në NjBSC	Sa kohë ka në këtë detyrë (vite)
1	Dr. Edit Bregu	Kryetar (FD)	4
2	Msc. Klevisa Muça	Anëtar (FSHESH/ DP)	1
3	Msc. Loreta Çiço	Anëtar (FSHESH/DE)	7
4	Msc Flavia Kenaj	Anëtar (FD)	7
5	Desada Minxolli	Anëtar (përqësues i studentëve)	1

Siç vërehet, dy nga aspektet më të rëndësishme në organizimin dhe funksionimin e kësaj njësie janë:

1. Konsolidimi në pozicion dhe prezenca ndër vite e anëtarëve të NJSBC, njohja e mirë e profilit dhe problematikave të ndryshme (trepj anëtarëve kanë 4-7 viet që mbajnë këtë detyrë të rëndësishme);
2. Afrimi i anëtarëve të rinj dhe ndërthurja e propozimeve të tyre me frymën e eksperiencës së anëtarëve më të vjetër në NJSBC.

III. Plani vjetor i punës së NJSBC viti akademik 2019-2020.

PLAN I VEPRIMTARIVE KRYESORE

NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

<i>Detyra me karakter të përgjithshëm</i>	AFATI I ZBATIMIT	STRUKTURAT	
		Përgjegjëse	B/punuese
<i>Zbatimi dhe monitorimi i politikave për sigurimin e cilësisë</i>	Viti Akademik 2019-2020	NJSBC	Komisioni për Garantimin e Standarteve dhe Cilësisë (KGSC) Fakultetet Departamentet
<i>Rishikimi i politikave për sigurimin e cilësisë bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” (Kreu X, Sigurimi i Cilësisë në Arsimin e Lartë)</i>	Viti Akademik 2019-2020	KGSC	NJSBC
<i>Bashkëpunimi me NJSBC apo organizma të tjera të sigurimit të cilësisë të IAL-ve homologe me qëllim shkëmbim e përvojës për garantimin dhe rritjen e cilësisë në arsimin e lartë</i>	Viti Akademik 2019-2020	NJSBC	Rektori Dekanët
<i>Monitorimi i punës me qëllim zbatimin e mekanizmave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në IAL</i>	Viti Akademik 2019-2020	NJSBC	Rektori Dekanët

			Departamentet
<i>Bazuar në pikën 4 të Ligjit Nr. 80/2015, NJSBC bashkëpunon gjatë vitit me Zyrën e Burimeve Njerëzore Karrierës dhe Jetës Studentore me qëllim evidentimin e të dhënave mbi punësimin e studentëve të KU “Wisdom” , për të vlerësuar efikasitetin e programeve të studimit të ofruara nga IAL jonë.</i>	Viti Akademik 2019-2020	ZBNJKJS NJSBC	Rektori Dekanët

DETYRA KONKRETE

<i>Përgatitja dhe miratimi i pyetësorëve për studentët e programeve bachelor dhe master i shkencave</i>	Tetor 2019	NJSBC	KGSC
<i>Organizimi i pyetësorëve për studentët e programeve bachelor dhe master i shkencave</i>	Janar 2020/Qershor 2020	NJSBC	KGSC
<i>Përgatitja dhe miratimi i pyetësorëve për pedagogët e KU “Wisdom”</i>	Tetor 2019	NJSBC	KGSC
<i>Organizimi i pyetësorëve për pedagogët e KU “Wisdom”</i>	Maj 2020	NJSBC	KGSC
<i>Përgatitja dhe miratimi i pyetësorëve për studentët e programeve të studimit me karakter profesional</i>	Tetor 2019	NJSBC Kordinatorët e prog.me karakter profesional	Rektori Dekanët Departamentet
<i>Organizimi i pyetësorëve për studentët e programeve të studimit me karakter</i>	Janar 2020/Qershor	NJSBC	Rektori

<i>profesional</i>	2020	Kordinatorët e prog.me karakter profesional	Dekanët Departamentet
<i>Përpunimi i rezultateve nga pyetësorët e plotësuar nga studentët dhe paraqitja e tyre me shkrim rektorit të IAL si dhe dekanëve të dy fakulteteve. Rezultatet e tyre bëhen pjesë e diskutimeve në rektorat dhe fakultetet apo departamentet përkatëse.</i>	Mars 2020/Korrik 2020	NJSBC	KGSC Kordinatorët e prog.me karakter profesional Rektori Dekanët Departamentet
<i>Përpunimi i rezultateve nga pyetësorët e plotësuar nga pedagogët dhe paraqitja e tyre me shkrim rektorit të IAL si dhe dekanëve të dy fakulteteve. Rezultatet e tyre bëhen pjesë e diskutimeve në rektorat dhe fakultetet apo departamentet përkatëse.</i>	Korrik 2020	NJSBC	KGSC Rektori Dekanët Departamentet
<i>Hartimi i kalendarëve semestralë të kontrollit të brendshëm të cilësisë për programet mësimore në ciklet e studimit: bachelor, master i shkencave si dhe programet me karakter profesional për vitin akademik 2019-2020</i>	Nëntor 2019/Prill 2020	NJSBC KGSC Departamentet	Rektori Dekanët
<i>Realizimi i relacioneve mbi kalendarët e kontrollit semestralë të kontrollit të brendshëm të cilësisë për programet mësimore në ciklet e studimit: Bachelor, master i shkencave si dhe programet me karakter profesional për vitin akademik 2019-2020</i>	Mars 2020/Korrik 2020	NJSBC KGSC Departamentet	Rektori Dekanët

<p><i>Organizimi në fund të çdo semestri i një takimi të studentëve me pedagogët e të dy Fakulteteve, Fakultetit të Drejtësisë dhe Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore mbi ecurinë e studentëve sugjerimet dhe problematikat e tyre gjatë semestrave dhe viti akademik, me qëllim evidentimin dhe marrjen e masave për një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit mësimor.</i></p>	<p>Në fund të çdo Semestri</p>	<p>Departamentet NJSBC KGSC</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore</p>
<p><i>Menaxhimi i procesit të shpërndarjes së formatit të raporteve semestrave në Stafin Akademik të KU "Wisdom" dhe plotësimi nga çdo pedagog i raportit semestral, ku ndërmjet të tjerave pasqyrohen përmbushja e objektivave dhe qëllimit të programit të lëndës (syllabusit), pjesëmarrja, kalueshmëria, nota mesatare, mendime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit mësimor për të ardhmen., etj</i></p>	<p>Në fund të çdo Semestri</p>	<p>NJSBC</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore</p>
<p><i>Përpunimi i të dhënave nga raportet semestrave të pedagogëve dhe realizimi i analizës SWOT. Realizimi i një raporti përmbledhës mbi pikat e forta dhe të dobta të institucionit.</i></p> <p><i>Formulimi i rekomandimeve përkatëse</i></p>	<p>Në fund të çdo Semestri</p>	<p>NJSBC</p>	<p>Rektori Fakulteti i Drejtësisë Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore</p>
<p><i>Dhënie e informacionit sa më të qartë dhe këshillave të dobishme ndaj strukturave të tjera të institucionit në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të performancës akademike dhe administrative.</i></p>	<p>Viti Akademik 2019-2020</p>	<p>NJSBC KGSC Rektori</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore</p>

<i>Analizimi i rezultateve (provime, esse, kolokiume) të studentëve me qëllim vlerësimin e performancës së programeve universitare. Hartimi i një raporti i cili do të jetë pjesë integrale e raportit përfundimtar mbi vitin akademik që realizon NJSBC.</i>	Në fund të vitit akademik	NJSBC	Departamentet Pedagogët KGSC
<i>Miratimi i formularit të ri të vlerësimin të performancës akademike (miratuar me vendimin Nr.219, më Dt. 25.04.2019) (Plotësohen nga Dekanët e Fakulteteve në fund të vitit akademik 2019-2020)</i>	Tetor 2020	NJSBC	Dekanët
<i>Plotësimi i formularëve të vlerësimin të performancës akademike për vitin 2018-2019 (formularët ekzistues)</i>	Tetor 2019	NJSBC	Dekanët
<i>Evidentimi i esesë më të mirë të studentëve me qëllim botimin e saj në Revistën Shkencore WISDOM</i>	Gjatë vitit	NJKSHMJ Departamentet	NJSBC
<i>Realizimi i Intervistave informale me studentët. Zbardhja e tyre nëq evidentohen probleme dhe përcjellja e tyre në departamentet përkatëse.</i>	Gjatë vitit	NJSBC	Departamentet
<i>Monitorimi i punës kërkimore shkencore dhe ngritjes akademike të stafit, përgatitja e sugjerimeve për NJKSHMJ</i>	Gjatë vitit	NJKSHMJ	KGSC NJSBC
<i>Miratimin e formularit të kërkimit shkencor në bashkëpunim me NJKSHMJ për vlerësimin e performancës së punës shkencore për vitin akademik 2019-2020.</i>	Në fillim të vitit akademik	NJSBC NJKSHMJ	Departamentet KGSC

<i>Dhënia e suportit të vazhdueshëm ndaj GVB të ngritura për procese të akreditimit në Institucion</i>	Viti Akademik 2019-2020	NJSBC	GVB përkatëse
--------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------	-------	---------------


Axhenda e akreditimeve të 5 programeve KU Wisdom 17.12.2019-18.05.2020 (bashkëngjitur në këtë plan)

<i>Analizë për përmbushjen e detyrave nga ana e NJSBC për vitin akademik 2019-2020. Hartimi i një raporti vjetor që analizon gjendjen e institucionit ose/dhe të programeve të studimit përkundrejt standarteve të cilësisë, arritjet përkatëse dhe mundësitë për përmirësim.</i>	Në fund të vitit akademik	NJSBC	Rektori Fakultetet
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------	-------	-----------------------

IV. Realizimet dhe veprimtaria e NJSBC viti akademik 2019-2020.


a. Vlerësim i politikave dhe qëllimi i sigurimit të cilësisë në IAL

Vlerat që karakterizuan veprimtarinë e NJSBC gjatë këtij viti akademik, bazuar edhe në rregulloren e saj janë :



- *Integriteti*, që do të thotë ndershmëri, objektivitet, aftësi, shmangie e konfliktit të interesave në ushtrimin e veprimtarisë.
- *Pavarësia dhe Objektiviteti*, që do të thotë pavarësi në ushtrimin e veprimtarisë dhe dhënie e opinioneve e gjykimeve objektive.
- *Profesionalizmi*, që do të thotë zbatim i standardeve profesionale me kujdesin e duhur profesional dhe korrektësi, mbështetur në metodologjitë dhe praktikat më të mira, si ato të universiteteve perëndimore.
- *Komunikim dhe Informim*, që do të thotë komunikim korrekt, objektiv, të qartë, konciz dhe konstruktiv gjatë veprimtarisë së tij.

KUW, në shërbim të rritjes së cilësisë, ka zhvilluar veprimtarinë e saj në tre drejtime kryesore: Së pari janë ndërtuar Politikat e cilësisë në nivel IAL-je. Së dyti mirëfunksionimi i strukturave që funksionojnë në drejtim të zhvillimit të vazhdueshëm të standarteve të cilësisë në IAL, Komisioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë dhe NjSBC . Së treti konsolidimi i mëtejshëm i mekanizmave që NjSBC përdor në përpjekjet për rritjen e dhe përmirësimin e mëtejshëm të standardeve ekzistuese të cilësisë në kuadër të hapësirës mbarë evropiane të Arsimit të Lartë.



Për të garantuar cilësinë, efektshmërinë e kërkuar dhe përmbushjen e standardeve, KU”Wisdom” ka krijuar dy struktura akademike të cilat tashmë kanë konsoliduar veprimtarinë e tyre ndër vite: NjsBC dhe Komisionin për Garantimin e Standarteve të Cilësisë. Politika për garantimin e standarteve të cilësisë janë nxjerrë në zbatim të Ligj Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (SUE), Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, strategjinë e zhvillimit të institucionit, të Statutit të KUW, si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë këtë fushë veprimi. Cilësia është në qendër të të gjitha aktiviteteve të KUW por në veçanti fokusohet në ngritjen e standardeve, duke njohur arritjet dhe promovimin e një kulture pozitive dhe bashkëpunuese në institucion. KUW ka ngritur politika të cilat mbulojnë NjsBC dhe të gjitha aktivitetet dhe palët e interesuara brenda institucionit lidhur me garantimin e standarteve . Qëllimet janë:

- të promovohet një kulturë në të cilën çdo fakultet, departament dhe person e sheh përmirësimin e cilësisë si përgjegjësi personale dhe kolektive;
- të zhvillohen strategji, politika, procedura, procese dhe iniciativa të cilat mbështesin një cikël efektiv të planifikimit, të implementimit, monitorimit dhe të përmirësimit- dhe të cilat e marrin parasysh kontekstin e jashtëm;
- të dizajnohen, të zhvillohen, të akreditohen dhe rregullisht të rishikohen, brenda dhe jashtë, të gjitha programet studimore në përputhje me standardet ligjore dhe me praktikën më të mirë në këtë fushë; pikësynimi ynë është që gjithashtu të sigurohemi se rezultatet e pritura nga të mësuarit dhe nga praktika e vlerësimit janë të përshtatshme për qëllimet e Institucionit tonë;
- të përkrahët mësimdhënia dhe mësim-nxënia efektive e cila e kombinon qasjen që udhëhiqet nga hulumtimi, me studentët në qendër;
- të përdoren të dhëna, materiale tjera analitike dhe udhëzime për praktikën e mirë, për t’u siguruar se vlerësimet dhe vendimet janë të hapura, transparente dhe të mbështetura në mënyrë të qartë, me informacion relevant;
- të sigurohemi se raportet dhe vlerësimet e rëndësishme, duke përfshirë këtë politikë, janë

publikuar;

- të sigurohet mbrojtja e integritetit dhe liria akademike;
- të përdoren në mënyrë më të mirë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe praktikata më të mira, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me trendet në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, Standardet e Bolonjës dhe Udhëzimet;
- të ndahen dhe të shpërndahen informacionet dhe vendimmarrjet me të gjithë “stejkholderët”, me qëllim që të sigurohemi se janë përfshirë të gjithë, se arritjet njihen dhe shpërblehen dhe se do të ketë menaxhim efektiv të performancës, përfshirë edhe nënperformancën. Funksionet e NjSBC janë parë nga ana e IAL-së tonë si një pjesë integrale e menaxhimit të procesit akademik-mësimor, por gjithashtu edhe si një instrument për rritjen e performancës. Sigurimi i cilësisë kërkohet të perfeksionohet edhe për një sërë arsyesh të tjera, si: zhvillimi dhe përmirësimi i kurrikulave në përputhje me standartet evropiane, rritja e e nivelit të aftësive profesionale dhe akademike të studentëve në përputhje me kërkesat dhe tendancat e tregut të punës, vendas e më gjerë; avantazhe në raport me konkurrencën nga IAL të tjera publike dhe private por edhe ndërkombëtarizimi sipas procesit të Bolonjës.


Përgjatë vitit akademik 2019 – 2020 në KUW u realizua procesi i akreditimit periodik institucional. Vlen të theksohet se IAL- ynë e ka vlerësuar maksimalisht këtë proces duke e trajtuar me seriozitet si dhe duke marrë të gjitha hapat e duhura për mbarëvajtjen e procesit por edhe dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar brenda të gjitha afateve të parashikuara në Legjislacionin për Arsimin e Lartë në RSH. Sipas shkresës me Nr.114/7 Prot. të datës 09.11.2020 nga ASCAL, KUW i është përcjellë Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm Institucional.

Krahas tij përgjatë këtij viti akademik është realizuar edhe akreditimi periodik i programit të studimit Bachelor në Psikologji si dhe procesi i akreditimit për herë të parë të programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi si dhe akreditimi për herë të parë i programeve të studimit me karakter profesional: Agjent i Pasurive të Paluajtshme, Asistent Social dhe Asistent Juridik.

Procesi i vlerësimit të jashtëm është realizuar nga ASCAL e cila ka përcjellë raportet e vlerësimit të jashtëm të hartuar nga ekspertët përkatës për secilin prej programeve të studimit. Momentalisht IAL është në pritje të mbledhjes së Bordit të Akreditimit për tu njohur me vendimet e akreditimit për IAL-në si dhe programet e studimit që ju nënshtruan procesit të akreditimit përgjatë këtij viti akademik.

b. Mekanizmat e sigurimit të cilësisë në IAL dhe rezultatet e gjetjeve

Konkretisht politikat e sigurimit të cilësisë gjatë vitit akademik 2019-2020 janë realizuar nëpërmjet këtyre mekanizmave:




I. Organizimi i Pyetësorit për Pedagogët

- Ky pyetësor është organizuar me qëllim krijimin e një panorame të përgjithshme që i jepet institucionit për të kuptuar më mirë nëpërmjet përgjigjeve pikpamjet që ka stafi akademik për institucionin në tërësi.
- Pyetësori është anonim, gjë që lejon shprehjen e mendimit të lirë nga ana e pedagogëve.
- Pyetësori realizohet në fund të vitit akademik.
- Gjatë vitit akademik 2019-2020 si rezultat i gjendjes së krijuar për shkak të COVID-19 si dhe realizimit të mësimin në platformat online, nga ana e NjSBC u përshtat pyetësori me qëllim që të evidentohet opinioni i tyre në kushtet e gjendjes së krijuar.
- Në përfundim të vitit akademik 2019-2020, NjSBC ka hartuar një relacion të përgjithshëm mbi rezultatet e mbledhura, i cili i drejtohet Rektorit dhe ju vendoset për dijeni Dekanëve të Fakulteteve të cilët i bëjnë objekt diskutimesh në dekanat rezultatet e tyre.

Paraqitja grafike e pjesmarrjes në pyetësor.

1- Numri i përgjithshëm i pjesmarrëve në pyetësor.

2- Numri i përgjithshëm i të anketuarve.



Për sa i përket grupit të pyetje që kishin të bënin me **Metodologjinë Didaktike**, të pyetur në lidhje me njohuritë paraprake të poseduara nga studentët janë të mjaftueshme për të kuptuarit e temave të trajtuara në auditor, të anketuarit me një shumicë kanë vlerësuar se ato janë shpesh të mjaftueshme si dije paraprake nga ana e studentëve.

Në lidhje me pyetjen nëse ekzistojnë procedura të mjaftueshme për koordinimin e programeve Omësimore të ofruara nga institucioni, shumica e pedagogëve janë shprehur se **Po**, ndërsa pjesa tjetër janë shprehur se shpesh këto procedura janë të mjaftueshme.

Të pyetur se a :

Jeni në përgjithësi i/e kënaqur nga mësimi i zhvilluar,

Ngarkesa mësimore e parashikuar për lëndët është e pranueshme,

Organizimi i përgjithshëm (provime, të ndërmjetme dhe përfundimtare) i studimeve është i pranueshëm,

Struktura didaktike në dispozicionin tuaj janë të përshtatshme, të anketuarit janë përgjigjur në shumicë me **Po**, duke vlerësuar se ata janë të kënaqur me mësimin e zhvilluar, me ngarkesën mësimore të parashikuar për lëndët si dhe me organizimin e përgjithshëm të studimeve apo me strukturën didaktike të vendosur në dispozicion të tyre.

Po ashtu të pyetur në lidhje me faktin nëse në auditor ka një ekuilibër të drejtë mes kohës së kushtuar për disiplinat kurrikulare dhe angazhimit të studentëve në projekte, në auditor ka një ekuilibër të drejtë mes kohës së kushtuar për disiplinat kurrikulare dhe angazhimit të studentëve në projekte, përgjigjet e marra ishin po ashtu pozitive duke vlerësuar se ato, si kurrikulat ashtu edhe angazhimi i studentëve ishin në një ekuilibër të drejtë.

Për sa i përket grupit të pyetje që kishin të bënin **Marrëdhëniet me Institucionin**,

të tilla si Pranoj vendimet e vendosura në mënyrë demokratike nga organet kolegjiale, Ofroj kontribute personale për vendimarrjen e organeve kolegjiale? Ajo që vendoset në takimet e senatit kontribuon pozitivisht për të drejtuar zgjedhjet e juaja akademike? Përshtatni

programimet e juaja mësimore me vendimet e marra kolektivisht? Përgjigjet përkatësisht për **Po** kanë dominuar ndërsa pjesa tjetër janë shprehur me **Shpesh** apo **Pak**.

Në lidhje me pyetjet për marrëdhëniet me drejtuesin të tilla si a e Lehtëson shpërndarjen në kohë të dokumenteve dhe komunikimit në Institucionit (vendime, udhëzime, etj.,)? Promovon kolegjalitetin për zgjidhjen e problemeve didaktike? Është i/e gatshme për të dëgjuar dhe për dialog? Di të fiksojë objektiva realiste dhe di t'i komunikojë ato qartësisht? Ka kapacitet për të përcaktuar mirë prioritetet në punë? Njeh mirë sektorin e aktivitetit të institucionit? Sheh nëse niveli i vartësve integrohet mirë, jo vetëm me punën e tyre, por edhe me institucionin? Përpiqet të krijojë një klimë pune që i jep secilit punonjës dëshirën për ta bërë atë të mirë? Përgjigjet e marra kanë qënë në një shumicë të cilësuar **pozitive** duke e vlerësuar maksimalisht në këtë mënyrë komunikimin me drejtuesit si një pikë kyçe në rritjen e performancës nga ana e të dyja palëve.

Të pyetur për Marrëdhëniet me kolegët, në lidhje me faktin se a “

Konsideroni të rëndësishëm, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, materialeve dhe përvojave me kolegët?

Në qoftë se mundeni ofroheni për të ndihmuar kolegët në nevojë?

Flisni lirshëm dhe gjendeni mirë me të tjerët në komunikim të ndërsjelltë?

Realizimi i qëllimeve të grupit ka prioritet më të lartë se cdo qëllim tjetër individual?

E besoni kolegun mjaftueshëm për të ndarë informacionin, perceptimin dhe feedbackun për njeritjetrin.

Grupi ushtron presion mbi anëtarët për të përmirësuar performancën?

*Përgjigjet e marra qënë **Po** në më të shumtën e rasteve e **Shpesh** në një masë më të vogël.*

Organizimi dhe funksionimi i Institucionit

*Organizimi i Institucionit i shërben qëllimeve të parapërcaktuara, Shërbimi i sekretarisë funksionon mirë? Përsonei i institucionit bashkëpunon për të garantuar një mirë funksionim të Institucionit ? Shërbimet Sanitare të këtij Institucioni janë efektive? Hapësirave dhe struktura në dispozicion të pedagogëve janë të përshtatshme (auditorët, zyrat, mjetet, printerat, etj)? Institucioni është e pajisur me laboratore dhe pajisje teknologjike funksionale për të mësimdhënien? Rreth 90% e tyre janë përgjigjur me **Po** në lidhje me këto pyetje ndërsa pjesa tjetër janë përgjigjur që **Shpesh**.*

Trajnimi dhe Formimi

Shumica e pedagogëve të anketuar kanë shprehur dëshirën që cilësinë e tyre akademike ta potencializojnë nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në konferenca të ndryshme shkencore, trajnime në punë, ndërsa pjesa tjetër se kanë pritshmërinë të rrisin pjesëmarrjen në workshope.

Si mendime dhe sugjerime eventuale ata janë shprehur se Takimet më të shpeshta mes pedagogeve dhe shefave të departamenteve për të diskutuar rreth problematikave të hasura dhe objektivave të punës do të ishin më frytdhënëse për rrijen e bashkëpunimit, dhe përmirësimin e cilësisë duke bërë që strukturat e koordinimit në rang institucioni të jenë më bashkëpunuese.

Si përfundim mund të themi se nga mendimet e shprehura prej pedagogëve që u bënë pjesë e anketimit ishin në përgjithësi me sens pozitiv duke qënë se ata vlerësuan në më të shumtën e rasteve me përgjigjet **Po** për shumicën e pyetjeve që kishin të bënin me marrëdhënien e tyre me institucionin, në lidhje me marrëdhënien e tyre me kolegët apo në raportin e tyre të ndërsjelltë me drejtuesit duke pranuar në këtë mënyrë se janë të kënaqur me bashkëpunimin në tërësi midis tyre dhe institucionit. Kjo është një shprehje se jemi në drejtimin e duhur për sa i përket organizimit dhe strukturës së përgjithshme të KUW, po gjithashtu krijimi i një mjedisi të përshtatshëm akademik dhe shkencor është në mbështetje të plotë të lirisë akademike dhe në nxitje të rritjes së cilësisë së brendshme të IAL-së tonë. Sigurisht në të ardhmen do të bëhen përpjekje edhe më të mëdha për të përforcuar mekanizmat akademikë e didaktikë për të rritur standartet e mësimdhënies e mësimnxënies tonë si dhe për të inkurajuar bashkëpunimin e brendshëm institucional.

II. Organizimi i *Pyetësorit për Studentët*

- Ky pyetësor është organizuar çdo semestër, pra 2 herë gjatë vitit akademik 2019-2020 dhe përmban jo vetëm me pyetje për pedagogët, por edhe për çështje të tjera, si lidhur me leksionet, komunikimin student-pedagog, infrastukturën mësimore etj.
- Referuar planit të masave të miratuar me Vendim nr. 10 të Senatit të KUW, me nr. 306 Prot. të datës 12.05.2020, pyetësorët e studentëve janë shpërndarë fizikisht në dy grupe (Grupi 1- studentët diplomantë, gjatë periudhës së parashikuar në plan për konsultime dhe Grupi 2- për studentët e viteve të ndërmjetme, gjatë periudhës së parashikuar në plan për konsultime).
- Gjatë vitit akademik 2019-2020 si rezultat i gjendjes së krijuar për shkak të COVID-19 si dhe realizimit të mësimin në platformat online, nga ana e NjSBC u përshtat pyetësori i studentëve me qëllim që të evidentohet opinioni i tyre përshtatur me mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor në kushtet e pandemisë.
- Përgjithësisht tendenca ka qenë për të marrë mendime për aspektet kryesore të zhvillimit të performancës dhe cilësisë në kushtet e transferimit të procesit të mësimdhënies dhe veprimtarime shkencore në variantin online.
- Numri i studentëve të anketuar ka ndryshuar nga njëri anketim në tjetrin, në varësi dhe të studentëve të pranishëm në momentin e kryerjes (sipas dy grupeve, grupit të studentëve diplomantë dhe grupit të viteve të ndërmjetme).
- Të gjithë pyetësorët janë përpunuar dhe rezultatet i janë paraqitur me shkrim rektorit dhe për dijeni dekanëve të dy fakulteteve.

III. *Kalendarët semestralë të Kontrollit të Cilësisë.* NjSBC.

- Gjatë muajit Tetor 2019, NjSBC hartoi kalendarin e kontrollit të brendshëm të cilësisë për programet mësimore të semestrit të parë për vitin akademik 2019-2020 dhe të semestrit të dytë.
- Si rezultat i zhvillimit të mësimin online në kushtet COVID-19, në bashkëpunim me departamentet dhe në përputhje me lirinë dhe autonominë akademike, është

asistuar online në seminarët dhe leksionet për lëndët përkatëse sipas një kalendari të paracaktuar nga vetë Njësia.

- Janë mbajtur relacionet përkatëse dhe në fund të muajve Shkurt dhe Korrik janë zhvilluar relacione përmbledhës narrative mbi ato çfarë është vërejtur gjatë kontrollit të çdo pedagogu, ndihma e ndërsjellët, shkëmbimi i përvojave ndërmjet pedagogëve për metodologjinë e mësimdhënies si dhe plotësimi nga studentët i pyetësorit me rubrika të ndryshme në lidhje me mësimdhënien / mësimnxënien për pedagogët, të cilat i kanë shërbyer sigurimit të cilësisë.

Sipas raporteve mund të përgjithësohej se .:

IV. Në fund të kontrolleve për të gjitha lëndët e semestrit, është organizuar një takim i përbashkët i Fakulteteve dhe departamenteve përkatës, përfaqësues nga NjSBC me studentët, ku janë ballafaquar me mendimet dhe opinionet e gjithësecilit në lidhje me problematika dhe sugjerime të mundshme referuar edhe situatës lidhur me mësimdhënien dhe aktivitetet e realizuara online në kushtet e pandemisë. Synimi ka qenë afrimi edhe më tepër i studentëve me personelin akademik duke i bërë ata më të angazhuar, si dhe më tepër pjesëmarrës në proceset organizative dhe vendimarrëse në Institucionin tonë.

V. Raporti semestral për çdo pedagog.

Relacioni në mbyllje të sezonit të provimeve të Semestrit të I-rë dhe të II-të, për realizimin e programeve të lëndëve dhe plotësimi nga çdo pedagog i raportit semestral, ku ndërmjet të tjerave pasqyrohen përmbushja e objektivave dhe qëllimit të programit të lëndës (syllabusit), pjesëmarrja, kalueshmëria, nota mesatare, mendime dhe rekomandime për përmirësimin e procesit mësimor për të ardhmen., etj. Përsa i përket zhvillimit të procesit mësimor online në semestrin e dytë, daljes së Urdhërit Nr. 91, datë 09.03.2020 me Nr. 1867 Prot. të Ministres së Arsmit, Sportit dhe Rinisë “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike”, në përputhje me udhëzimet dhe sugjerimet e MASR u ra dakort që mësimi do të vazhdonte duke shfrytëzuar **Portalin e studentit** në faqen zyrtare të

Kolegjit www.wisdom.edu.al si dhe kanalet e komunikimit online si psh: Google classroom, (hangouts call), Video Call Skype, Zoom Video Call, shfrytëzimit të e-mailit etj.

Krahas këtyre masave ju është kërkuar çdo anëtari të stafit akademik të hartojnë një Raport individual mbi punën e kryer në kushtet e gjendjes së krijuar deri në datën 30 qershor 2020. Është zhvilluar mësimi dhe shkëmbimi i informacionit për çdo lëndë nga pedagogët përkatës sipas Orarit Mësimor të Sem.II, viti akademik 2019-2020 në dy Fakultetet, FD dhe FSHESH.

Gjatë zhvillimit të leksioneve *sipas raportimeve*, u aplikua metoda e të mësuarit aktiv, duke ndërthurur dimensionin teorik me atë praktik për rritjen e nivelit tekniko-profesional të studentit., gjatë semestrit të dytë, u zhvillua në mënyrë të rregullt mësimi online me studentët e të gjitha viteve të studimit për cdo program mësimor, po ashtu u përmbush vijueshmëria e procesit mësimor në platformën “Portali i studentit” si dhe platformat e tjera të përdorura nga ana jonë. Pas përfundimit të procesit të rregullt mësimor me studentët rezultoi që janë ruajtur standartet bazë të procesit të mësimdhënies, janë përdorur dhe platforma të tjera të mësimin në distancë si Google Classroom apo Zoom, E-mail.

Standartet e respektuara, rezultuan të jenë:

- 1- Është realizuar një proces shpjegimi në format audio, por nuk i'u janë shmangur shpjegimit në format audio (nëpërmjet zërit), duke e shoqëruar me elementë të tjerë në formate powerpoint, excel, pdf apo të ngjashme. Pra, shpjegimi në format audio që është standardi bazë nuk ka munguar.
- 2- Leksionet apo seminarët/ushtrimet janë realizuar sipas orëve të miratuara në planin mësimor për semestrin e dytë.
- 3- Studentët përmes këtij procesi kanë patur mundësi të ruajnë leksionet dhe të aksesojnë sipas mundësive të tyre teknologjike

Disa prej pikave të forta të raportuara nga vetë stafi akademik në relacionet e paraqitura pranë Koordinatorit të NJSBC përFD dhe FSHESH .

-Angzhim maksimal të administratës, personelit përgjegjës për teknologjinë, bibliotekën online etj, për të shfrytëzuar maksimalisht kanalet e komunikimit dhe studimit online në këto ditë të vështira.

-Angazhim dhe solidarizim nga ana e studentëve të cilët kanë shprehur gatishmërinë për ta kuptuar vështirësinë e situatës dhe kane ndjekur ciklet e leksioneve me pedagogët përkatës nëpërmjet kanaleve online të komunikimit.

-Angazhim maksimal nga ana e stafit akademik në përcjelljen e informacionit lëndor dhe realizimin e procesit mësimor-akademik nëpërmjet kanaleve online të komunikimit si psh: Google classroom, (hangouts call), Video Call Skype, Zoom Video Call, shfrytëzimit të e-mailit etj.

-Feedback-u i studentëve deri më tani ka qenë përgjithësisht pozitiv dhe me vlerësime mbi punën e kryer nga stafi akademik dhe drejtues në Fakultetin e Drejtësisë.

Dsa prej pika të dobëta të evidentuara kanë qenë:

-Vështirësia në përballimin psikologjik të kësaj situate të vështirë në kushtet e përhapjes së COVID-19, ka sjellë vështirësi në të përqendruarit dhe të kuptuarit e procesit mësimor.

-Pamundësia teknike për të realizuar apo transferuar çdo aspekt të procesit mësimor në auditor në variantin online.

-Mbetet fakti se jo të gjithë studentët kanë mundësi që të jenë online në oraret e përcaktuara, apo vështirësi teknike që lidhen me linjat e internetit.

VI. Intervistat me studentët.

Intervistat jo formale me studentët, për procesin mësimor në përgjithësi dhe për probleme të veçanta që studentët hasin përgjatë një semestri apo viti akademik. Përgjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 si rezultat i detyrimit të distancimit fizik për shkak të COVID-19, ky proces është zhvilluar i përzierë online si dhe fizikisht duke respektuar masat e vendosura nga autoritetet përkatëse.

VII. Performanca e studentëve.

Ajo arrihet të vëzhgohet përmes vënies në funksionim të një mekanizmi monitorues. Ky mekanizëm, që në vetvete përbën edhe një gjetje apo tregues të cilësisë, mbështetet mbi pesë shtylla apo elementë që konsistojnë në:

- Vijueshmërinë e tyre në leksione, pjesëmarrjen dhe angazhimin në zhvillimin e debatit dhe të shkëmbimit të opinioneve në grupe gjatë orëve të seminarit (në semestrin e parë *në klasë* ndërsa në semestrin e dytë *online*, rezultatet janë evidentuar në relacionet përkatëse të personelit akademik të KUW;
- Nivelin cilësor të angazhimit të tyre në procesin e debatit dhe shkëmbimit praktik të opinioneve gjatë zhvillimit të orëve të seminareve, përmes ballafaqimit të kazuseve të importuara nga praktika gjyqësore, administrative si dhe psikologjike.
- Detyrën e Kursit e cila përbën domethënien akademike të studentit. Përmes organizimit dhe shpërndarjes së disa tematikave në grupe te veçanta është siguruar reagimi i studentëve për tema të përbashkëta, duke rritur ndjeshëm edhe shanset e identifikimit të nivelit të cilësisë së tyre në lidhje me shprehjen dhe kohezionin e dijeve dhe të dhënave të tyre akademike.
- Kolokiumin, i cili përfaqëson arritjen e studentit në nivel semestral. Në hartimin e tezave në këtë “ballafaqim student-pedagog” i është kushtuar vëmendje e veçantë arritjes së vlerës praktike të këtyre tezave. Mënyra e testimit gojor ose me shkrim e studentëve ka krijuar një avantazh të padiskutueshëm si për studentin, i cili ka pasur në posedim hapësirën e nevojshme shprehëse të dijeve të tij, ashtu dhe për pedagogun që ka ushtruar në mënyrë të ndërsjellët një kontroll më të gjerë dhe më efikas mbi përgatitjen e studentit.
- Testin përfundimtar, që realizohet me anën e provimit të përgjithshëm apo të punimit për mbrojtjen e diplomës.

VIII. Ndhima e ndërsjellët ndërmjet pedagogëve, shkëmbimi i eksperiencave.

- Element i rëndësishëm i veprimtarisë së NJSBC është vlerësuar edhe ndihma e ndërsjellët ndërmjet pedagogëve dhe shkëmbimi i eksperiencave mbi metodologjinë e mësimdhënies.

- Janë organizuar nga ana e FD dhe FSHESH trajnime me pedagogët e rinj për metodologjinë e mësimdhënies dhe për probleme të tjera që do të shërbejnë rritjes së cilësisë së mësimdhënies/mësimnxënies, në funksion të rritjes së cilësisë së procesit mësimor.

IX. Veprimtaria kërkimore shkencore e stafit si dhe mundësi për angazhim të studentëve.

- Në bashkëpunim me NjKSH&MJ është miratuar formati mbi raportimin e veprimtarisë për kërkime shkencore të stafit për vitin akademik 2019 -2020, me afat plotësimi deri në 30 Tetor 2020. Qëllimi i NjSBC është dhe do të jetë padiskutim edhe vlerësimi i përformacës dhe cilësisë së kërkimit shkencor të stafit akademik dhe forcimi në bashkëpunim me NjKSH&MJ i mekanizmave për ta rritur dhe zhvilluar angazhimin e stafit në aktivitete shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Edhe pse si rezultat i pandemisë ka patur kufizime përse i përket realizimit të veprimtarive kërkimore-shkencore nga ana e strukturave drejtuese dhe përgjegjëse për kërkimin shkencor në IAL ka patur mbështetje maksimale për pjesëmarrje në aktivitete shkencore të realizuara virtualisht, botime në revista me faktor impakti krahas një numri të konsiderueshëm aktiviteteve të realizuara në ambjentet e KUW por edhe online gjatë vitit akademik 2019-2020.
- Nga ana e NjSBC i dërgohen propozime të vazhdueshme Bordit të Revistës shkencore “Wisdom” si dhe personelit akademik, bazuar në Planin vjetor të Veprimtarisë së kësaj njësie për vitin akademik 2019-2020, sipas të cilit është kërkuar evidentimi i eseve më të mira të studentëve në bashkëpunim me Departamentet, Pedagogët, ZBNJJK&JS, me qëllim botimin e saj në Revistën Shkencore “Wisdom”.

Në përfundim procesit mësimor pra të vitit akademik, është hartuar një Raport përmbledhës për titullarët e njësisë kryesore dhe titullarin e institucionit për ecurinë e procesit mësimor, pikat e forta dhe të dobëta, kërcënimet dhe rreziqet e mundshme, me sygjerimet përkatëse. Qëllimi i realizimit të këtij raporti do të jetë sugjerimi i masave dhe dhënia e propozimeve për përmirësimin dhe rritjen e vazhdueshme të standartit të cilësisë së procesit

akademik.

Gjatë zhvillimit të procesit të anketimit mënyra e menaxhimit të pyetësorëve ishte transparente dhe përzgjedhja e studentëve ishte e rastësishme. U respektua një kohë e përshtatshme në një ditë normale konsultimi për kryerjen e anketimit, ku studentët plotësuan me vullnet të lirë dhe të plotë rubrikat e pyetësorëve.

Nga analiza e përgjithshme e përgjigjeve të mara prej pyetësorit u vërejt se në përgjithësi për të gjitha programet dhe vitet marrëdhënia institucion-student është e mirë, studenti ndihet mirë si me anën infrastrukturore ashtu edhe me atë didaktike dhe akademike. Nuk ka pakënaqësi në lidhje me gjithë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, po ashtu ka një përputhshmëri midis pritshmërive me të cilat studentit aksesohet në institucion dhe asaj se çfarë institucioni ofron në realitet për të mbuluar të gjitha shërbimet e tij akademike dhe jo vetëm.

Për sa i përket fushës së pakënaqësive të shfaqura prej studentit u vu re se këta të fundit nuk kishin sugjerime të shprehura në lidhje me asnjë prej proceseve të ofruara prej KUW. Në përgjithësi studentët janë të kënaqur me atë që ju ofrojnë kurset e studimit, me mjetet e nevojshme për ushtrimet praktike (dokumentacioni, pajisjet informatike, instrumentat, mjete laboratorike, etj.) pasi që ato janë të disponueshme dhe në masën e duhur, me atë që ju ofrohet për sa j'u përket institucioneve/qendrave/strukturave ku zhvillohet praktika profesionale (stazh, punë laboratorike, ushtrime, projekte, etj. Po ashtu ata shfaqën në përgjithësi të kënaqur me përshtatshmërinë e sallave në të cilat zhvillohet mësimi (ka vënde, shikohet, dëgjohet, etj).

Studentët u shprehën se ishin të kënaqur mbi mënyrën e zhvillimit të mësimin online gjatë pandemisë si dhe është respektuar orari i mësimin nga pedagogët njësoj si në auditore. Në përgjithësi leksionet në secilin prej kurseve kanë rezultuar të qarta të bazuar në një formim shkencor të kënaqshëm dhe profesional duke i bërë programet e këtyre kurseve interesante dhe tërheqëse për studentin, duke stimuluar edhe pjesëmarrjen aktive të studentëve nga pedagogët e lëndës dhe sigurisht duke rritur komunikimin midis vetë studentit dhe pedagogut.

Në përgjithësi leksionet në secilin prej kurseve kanë rezultuar të qarta të bazuar në një formim shkencor të kënaqshëm dhe profesional duke i bërë programet e këtyre kurseve

interesante dhe tërheqëse për studentin, duke stimuluar edhe pjesëmarrjen aktive të studentëve nga pedagogët e lëndës dhe sigurisht duke rritur komunikimin midis vetë studentit dhe pedagogut.

c. Të dhëna mbi vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë së studentëve dhe vlerësimin e tyre sipas programeve të studimit.

-Numri i studentëve në KUW

Programet Bachelor	Numri i studentëve	Programet Master i Shkencave	Numri i studentëve	Programet me karakter profesional	Numri i studentëve
“Drejtësi”	117	“E drejtë Penale”	39	“Asistent Juridik”	33
“Psikologji”	8	“E drejtë Civile “	44	“Asistent Social”	12
“Menaxhim Biznesi	86	“Psikologji shkollore dhe edukimi”	12	“Agjent i pasurive të paluajtshme”	22
“Financë-Bankë”	46	“Administrim Biznesi”	34	“Asistent Administrativ”	9
Gjithsej	257	Gjithsej	129	Gjithsej	76
Gjithsej numri i studentëve të rregjistruar në KUW viti akademik 2019-2020				462	

-Numri i të diplomuarve sipas fakulteteve, niveleve dhe programeve të studimit të ofruara;

FAKULTETI I DREJTËSISË			
Programi Bachelor	Numri i të	Programet Master i Shkencave	Numri i të

2019-2020	diplomuarve	2019-2020	diplomuarve
“Drejtësi”	42	E drejtë Penale	13
		E drejtë Civile dhe Tregtare	21
Gjithsej	42	Gjithsej	34
Totali i të diplomuarve në Programet e ciklit të parë dhe të dytë = 76			

FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE SHOQËRORE			
Programet Bachelor	Numri i të diplomuarve	Programet Master i Shkencave	Numri i të diplomuarve
2019-2020		2019-2020	
“Menaxhim Biznesi”	30		
“Financë Bankë”	16		
“Psikologji”	12	Psikologji Shkollore dhe Edukimi	12
Gjithsej	58	Gjithsej	12
Totali i të diplomuarve në Programet e ciklit të parë dhe të dytë = 70			

Totali i studentëve të diplomuar në KUW në vitin akademik 2019-2020 është 146 studentë gjithsej.

-Numri i studentëve të transferuar (shoqëruar me informacion mbi institucionin e parë, programin e studimit dhe semestrin ku transferohet);

VITI AKADEMIK 2019-2020					
--------------------------------	--	--	--	--	--

Transferime	Bsc Drejtësi	Bsc Menaxhim Biznesi	Bsc Financë	Bsc Psikologji	Msc “ E drejtë Penale”	Msc “E drejtë Civile dhe Tregtare “	Msc “Psikologji shkollore dhe edukimi “
Ndërmjet Universiteteve	17	29	21	6	1	3	-
Gjithsej Transferime Bachelor	73 në total						
Gjithsej Transferime Master	4						
Gjithsej Total	77						

-Mesatarja e studentëve sipas viteve

Viti akademik 2019-2020	Bachelor Drejtësi (mesatarja)		
	Viti I	Viti II	Viti III
	7.95	7.93	7.86
	Bachelor Financë-Bankë		
	Viti I	Viti II	Viti III
	6.64	6.92	7.07
	Bachelor Psikologji		
	Viti I	Viti II	Viti III
	8.08	8.21	7.66
	Bachelor Menaxhim-Biznes		
Viti I	Viti II	Viti III	
6.27	5.6	6.59	
Master Shkencor Psikologji Shkollore dhe Edukimi			

	Viti I	Viti II
	8.83	8.45
	Master Shkencor E drejtë Penale	
	Viti I	Viti II
	7.69	8.01
	Master Shkencor E drejtë Civile dhe Tregtare	
	Viti I	Viti II
	8.18	7.71
	Master Shkencor në Administrim-Biznesi	
	Viti I	Viti II
	9.6	7.61
	Prog.me Karakter Profesional Asistent Juridik	
	Viti I	Viti II
	7.56	6.97
	Prog.me Karakter Profesional Agjent i Pasurive të Paluajtshme	
	Viti I	Viti II
	6.68	8.00
	Prog.me Karakter Profesional Asistent Social	
	Viti I	Viti II
	7.89	7.95
	Prog.me Karakter Profesional Asistent Administrativ	
	Viti I	Viti II
	7.19	-

Me qëllim evidentimin e studentëve të ekselencës në KUW po ju paraqesim më poshtë këto të dhëna:

Me mesatare 9.5 e lart në Bachelor në Drejtësi kanë dalë **8** studentë nga **117** (që janë në total).

Me mesatare 9.5 e lart në Bachelor në Psikologji kanë dalë **0** studentë nga **8** (që janë në total).

Me mesatare 9.5 e lart në Bachelor në Financë-Bankë kanë dalë 0 studentë nga nga **46** (që janë në total).

Me mesatare 9.5 e lart në Bachelor në Menaxhim-biznesi kanë dalë **0** studentë nga nga **86** (që janë në total).

Me mesatare 9.5 e lart në Master Shkencor në të dy Drejtimet e ofruara në Fakultetin e Drejtësisë: E drejtë Penale 1 student dhe E drejtë Civile dhe Tregtare kanë dalë 2 studentë nga **83** (që janë në total).

Me mesatare 9.5 e lart në Master Shkencor në Psikologji Shkollore dhe Edukimi kanë dalë **2** studentë, nga **12** (që janë në total).

Me mesatare 9.5 e lart në Master Shkencor në Administrim Biznesi kanë dalë 1 student, nga **34** (që janë në total).

Me mesatare 9.5 e lart në Programin e studimit me karakter profesional Asistent Juridik kanë dalë **1** studentë, nga **33** (që janë në total).

Me mesatare 9.5 e lart në Programin e studimit me karakter profesional Agjent i Pasurive të Paluajtshme kanë dalë **2** studentë, nga **22** (që janë në total).

Me mesatare 9.5 e lart në Programin e studimit me karakter profesional Asistent Social kanë dalë **1** studentë, nga **12** (që janë në total).

Me mesatare 9.5 e lart në Programin e studimit me karakter profesional Asistent Administrativ kanë dalë 0 studentë, nga **9** (që janë në total).

d. Vlerësimi dhe të dhëna mbi ecurinë e punës kërkimore shkencore të personelit akademik sipas Fakulteteve

Monitorimi dhe raportimi i të dhënave mbi kualifikimin dhe rritjen akademike dhe shkencore të personelit akademik që mbulon Programet e Studimit që ofrohen në IAL-në tonë lidhet me

planin strategjik të zhvillimit të KUW 2018-2023, i cili përsa i përket Personelit Akademik dhe prioriteteve në kualifikimin e personelit akademik ka këto objektiva:

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave rekrutuese transparente për një personel akademik sa me kualitativ. Zbatimin e politikave që nxisin rritjen e performancës së personelit dhe kerkimit shkencor. Krijimin e mundësive për shpërblim në varësi të punës së kryer. Krijimin e një mjedisi të shëndetshëm e miqësor në Kolegj. Nxitja e mendimit dhe diversitetit akademik e shkencor te personelit akademik. Nxitja dhe krijimi i mundësive për lëvizjen e stafit në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

KUW angazhon në kërkimin shkencor profesorë me tituj dhe grada si pjesë e stafit akademik, duke u kujdesur njëkohësisht që në këtë proces të përfshijë gradualisht me standartet e duhura brezin e ri të pedagogëve me synimin në rritjen dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre, Ndër indikatorët e kualifikimit akademik do të jenë:

- Gradat dhe titujt shkencore;
- Eksperienca në fushën e mësimdhënies;
- Eksperienca profesionale;
- Botime akademike;
- Kualifikimet ekstra kurrikulare;

Në zbatimin e këtyre objektivave janë angazhuar strukturat përkatëse të institucionit, si njësitë bazë të cilat monitorojnë aktivitetin shkencor të personelit akademik, si edhe njësi mbështetëse, që ndërveprojnë aktivitetin shkencor të personelit sikurse është Njësia e Kërkimit Shkencor dhe me marrëdhënieve me Jashtë, (NJKSH&MJ), NJSBC dhe Zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore.

NJKSHMJ është struktura, e cila në bashkëpunim me NJSBC, mbështetur në rregulloren⁴ e saj mbi koordinimin dhe monitorimin e cilësisës së procesit të mësimdhënies, ku përfshihet rritja akademike dhe shkencore e personelit akademik ka ndertuar mekanizmat e duhur për të arritur

⁴ Rregullore e NJKSH&MJ

këtë objektiv. Konkretisht NJSBC ka miratuar me vendim Nr.218.dt25.05.2019⁵, Formulari për vlerësimin të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike e kërkimore-shkencore⁶, i cili në këtë vendim është rifreskuar pasi ka qenë aplikativ edhe në vitet e mëparshme i miratuar nga NJSBC dhe i aplikuar nga NJKSH&MJ. Ky formular është i detyrueshëm për t'u plotësuar në formë periodike, kryesisht një vjeçare. Në rast kërkesash specifike nga institucionet monitoruese të IAL-së ose në rast procesi akreditimi, raporti i të dhënave për personel akademik realizohet nga NJKSHMJ për periudha më të gjata kohore në Dekanat ose Rektorat.

Gjithashtu një tjetër njësi me të cilën realizohet koordinimi lidhur me të dhënat e kualifikimeve të personelit akademik është ZBNJKK&JS, ku raportohet për kualifikimet, si marrja e gradave shkencore ose titujve shkencore, materialet certifikuese të punës kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe dokumentacionin përkatës nga ana e personelit akademik në dosjet e tyre personale të punës.

d. 1. Ndërlidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Synimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore të jetë ngritja e vazhdueshme e standarteve akademike në KUW dhe përmirësimi sistematik i cilësisë së arritjeve të studentëve. I gjithë stafi akademik të angazhohet në procesin e integritimit të rezultateve të punës së tyre kërkimore-shkencore në procesin mësimor (leksione, seminare, monografi shkencore etj.) Për këtë qëllim, të organizohen seminare dhe tryeza diskutimesh akademike, me pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve. Në këto veprimtari anëtarët e stafit akademik të përditësojnë njohuritë e studentëve me të rejtat nga veprimtaria e tyre hulumtuese dhe ndihmojnë në mjeshtërimin e kompetencave në përputhje me fushat e ekspertizës.

d. 2. Vlerësimi dhe ecuria e punës kërkimore shkencore në Fakultetin e Drejtësisë

NJKSH&MJ, në FD, ka realizuar objektivat e parashikuara në programin vjetor të veprimtarive Kërkimore Shkencore për vitin akademik 2019-2020. Një nga prioritetet e Fakultetit ka qenë edhe

⁵ Vendim i NJSBC

⁶ Formulari i vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike e kërkimore-shkencore

zgjerrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë, institucione shtetërore, kompani private, zyra noterie apo avokatie etj.,

Konferencë shkencore: NjKSHMJ në bashkëpunim me departamentet e FD për të rritur performancën akademike sikurse edhe përfshirjen e studentëve në realizimin e kërkimeve shkencore, artikujve dhe mini studimeve realizoi Konferencën Kombëtare me temë: “*Aspekte Juridike të krimeve kompjuterike dhe praktika e organeve tona ligjzbatuese për parandalimin, zbulimin dhe goditjen e tyre*” Prill 2019 dhe në proces botimi Procceding i konferencës. Kjo Konferencë” me pjesëmarrje të gjere të stafit akademik nga KUW si edhe përfaqësues dhe personalite të administratës publike dhe private në Shqipëri. Konferenca u zhvillua në ambjentet e KUW datë 10.04.2019 ora 10:00, e cila vazhdoi disa orë ku debati mbi veprat penale kibernetike nxiti diskutime në të gjithë audiencën.

Konferencë Kombëtare: “Thyej Tabune: Qarku Vicioz i Çështjeve të Shëndetit Mendor dhe Dhuna Familjare në Shqipëri” e organizuar nga Shoqata “Në Dobi të Gruas Shqiptare” & The Ballkanista/Alice Taylor në bashkëpunim me Kolegjin Universitar "Wisdom", Qendra “Këshillimore për Njerëz me Aftësi të Kufizuar”, Qendra "Klinika Ligjore Wisdom" dhe Klinika Psikologjike "Urtesia".

Seminar shkencor: Në datat 30-31 Janar 2020 NjKSHMJ në FD në bashkëpunim me departamentet në kuadër të lëndës “E drejta Romake “ ka ftuar profesoreshën Prof. Maria Casola, Università degli Studi di Bari “Aldo Moro”, Dipartimento Jonico in Sistemi giuridici ed economici del Mediterraneo Società Ambiente Culture CEDICLO Centro Interdipartimentale di Ricerca “Studi di Diritti, Culture, e cila referoi për studentët temën: “Roma dhe Mesdheu, Siguria dhe Lëvizshmëria; *Res communes’ omnium* në të drejtën romake” (“Roma e il Mediterraneo, Sicurezza e Circolazione; *Le Res communes omnium nel diritto romano*”) E cila solli nje dinamike ndryshe te perceptimit te “Drejtës Romake” e pare nga kendveshtimi qe lektoret italiane e trajtojnë.

Konferencë Studentore: Në zbatim të Planit Vjetor të Aktiviteteve Shkencore, NJKSHMJ në bashkëpunim me Departamentet e të Drejtës Publike dhe Private realizuan më datë 14 /05 /2019, Konferencën Studentore Ndëruniversitare me temë: “Perspektivat dhe Sfidat e Integritimit në Bashkimin Evropian” në mjediset e KUW.

Konferencë kombëtare online: organizuar nga Qendra “Klinika Ligjore Wisdom” dhe FD në KUW, 10 maj dita kombëtare e drejtësisë dhe ofrimi i shërbimeve ligjore në kohë pandemie" me pjesëmarrjen e saj Znj.Etilda GJONAJ, Ministre e Drejtësisë së RSH.

Projekte kerkimore: NjKSH&MJ ne bashkepunim me Departamentet janë përfshirë në projekte kerkimore pedagogja e Departamentit Publik Edit Bregu në projektin Erasmus + KA2: COOPERATION FOR INNOVATION AND THE EXCHANGE OF GOOD PRACTICES”. Projekti titullohet“ Studime Kulturore në Biznes” menumerreference2018-1-IT02-KA203-048091.<https://www.culturalstudiesinbusiness.org/>.Projekti parashikon shkëmbimin e praktikave të mira midis universiteteve partnere, periudha trajnimi për mësuesit dhe studiuesit e rinj. Projekti zgjat 2 vjet. Qershor 2018 – Korrik 2020._Në kuadër të implementimit të Projektit Erasmus Plus, ref. No. 2018 – 1- IT02-KA203-048091 “Cultural Studies in Business”, në të cilin KUW është institucion partner, u realizua Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temë: “CULTURAL STUDIES IN BUSINESS”, më datë 9 Maj 2019, me partnerët ndërkombëtarë: “Sapienza Universita Di Roma” – Itali; “Highers Education Institution Kumanovo”- Maqedoni; “Vilniaus Gedimino Technikos Universitetas” – Lituani; “University of Split” – Kroaci; “Universida de Beira Interior” – Portugali; si dhe organizatën “Jump associazione culturale” - Itali; Objektivi kryesor i Projektit CSB është të hartojë një Kurrikulë Evropian Inovative në Ekonomi, Shkenca Sociale dhe Shkenca Humane.

Workshop: Po ashtu, në kuadër të këtij Projekti ndërkombëtar, më datë 17 dhe 18 Janar, 2020, në KUW u organizua aktiviteti `4th Transnational Meeting`, ku ishin të pranishëm përfaqësues të vendeve partnere të këtij projekti, si dhe workshop-i me qëllim prezantimin e një lënde të re pilot në kurrikulën e Programeve Bachelor, të Departamentit të Ekonomisë, në KUW, e cila

titullohet `Studime Kulturore në Biznes`, e cila do të implementohet në të gjithë vendet partnere. Ky workshop ishte me shumë vlerë për studentët e FD, të cilët do të ndjekin këtë modul në semestrin e II-të me lektor Dr. Edit Bregu, që njëkohësisht është edhe hartuese e lëndës.

Workshop: me stafin akademik në ambjentet e Kolegjit Universitar Wisdom, me profesorin amerikan Ronald M. Nate, Ph.D, Professor Economics Brigham Young University-Idaho.

Workshop: NJKSHMJ në bashkëpunim me bashkëpunim me Institutin për kërkim dhe Zhvillim “Wisdom” më datë 01/11/2019 organizoj workshopin “Imazhet gjinore në media”, ku u diskutua mbi rëndësinë që ka etika e komunikimit mediatik në shoqëri dhe çështjen e barazisë gjinore.

Workshop: NJKSHMJ në bashkëpunim me bashkëpunim me IKZH Wisdom më datë 21/11/2019, në kuadër të implementimit të projektit nga Qendra “Fokus” organizuan trajnimin me temë “Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve” Në këtë trajnim ishin të pranishëm përfaqësues të institucioneve shtetërore me profile jurist, psikolog si dhe pedagog të KUW.

Workshop: NJKSHMJ në bashkëpunim me RE/MAX INFINITY realizuan workshop me temë “Të njihemi me procesin e negocimit dhe marketingut në Real Estate” me trajnues Besard Rusi në datë 15/01/2020 një nga aksionerët e kompanisë Remax Albania and Kosovo dhe Brokëri disa zyra Remax në Tiranë.

Trajnim: Bazuar në rregulloren e Njesisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, mbi krijimin e lehtësirave të bashkëpunimit dhe përfshirjen e studentëve në trajnime, Workshope kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ndërkombëtare u krijua mundësia e përfshirjes së një studenti të FD trajnimin” Wmpowering Youth Entepreneurship”. Ky trajnim u organizua në kuadër të programit Erasmus + Youthpass. Trajnimi u zhvillua nga data 17/02/2020 deri në datën 25/02/2020 në Mostar, Bosnje Hercegovinë.

Trajnim: organizuar në Bosnia Herzegovina në kuadër të projektit Erasmus + i financuar nga European Union ku jemi përfaqësuar nga studentët tane që janë përzgjedhur për tu bërë pjesë e trajnimit pas aplikimit online (Marlin Hoxha dhe Ardit Loka.)

Trajnim: në kuadër të projektit Erasmus + i financuar nga European Union organizuar në Malin e Zi përfaqësuar KUW me studentët Anxhela Muça dhe Altea Malaj.

Trajnim: me të ftuar Znj. Lutjona Lula dhe Emi Dautaj anëtare të bordit të ESN Tirana dhe njohëse të programit Erasmus+ informimin, për mënyrat e aplikimit për projektet Erasmus.

Leksion i hapur: Takime të studentëve tane me drejtoreshën ekzekutive të qendrës “Në dobi të gruas shqiptare”, Znj. Sevim Arbana, për përfaqësimin në ofrimin e asistencës për plotësimin e formularit për strehimin e personave banesat e të cilëve ishin dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

Leksion i hapur “Genocidi në Kosovë” mbajtur nga akademiku nga Kosova për çështjet e ligjit dhe shtet-ndërtimi Z.Jahja LLUKA.

Leksion i hapur: NJKSHMJ në bashkëpunim me Departamentet e së Drejtës Private dhe Publike organizoi në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të kërkimit shkencor për studentët e programeve dy vjeçare me karakter profesionale “Asisten Juridik” dhe “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” në FD, trajnimet profesionale me eksperte në fushën Juridike. Ekspertët pjesëmarrës janë: znj. Elona HASKA Ish-eksperte e Ministrisë së Drejtësisë *me tematikë: “Legjislacioni dhe teknikat e hartimit të ligjit” në datë 28.05.2019 z.Gentian KOLLESHI Avokat, me tematikë: “Etika e Avokatit” në datë 29.05.2019 z.Maringlen Meta (Avokat,) me tematikë: “ E drejta e pronësisë në kuadër të ligjit 7501 “problematikat praktike, padia e rivendikimit si mjet juridik për mbrojtjen e pronësisë.”, në datë 30.05.2019*

Trajnim: “Mbi profesionet e lira” me eksperten znj. Drilona Bara, e cila trajnoi studentët e programeve profesionale “Asistent Juridik” .

Trajnim: “Të njihemi me Marketingun e Bizneseve mbi Pronat e Paluajtshme” mbi informimin e studenteve të programit profesional agjent i pasurive të paluajtshme mbi shoqërinë investitore ndërkombëtare ARMADA SH.P.K

Trajnim: “Shitja dhe Marketimi në Pasuritë e Paluajtshme” me studentët e programit të studimit me karakter profesional “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” në FD.

Internship: i realizuar në ambjentet e Agjencisë CENTURY21 Expert nga studentja e Programit të Studimit me karakter profesional Agjent i Pasurive të Paluajtshme Aleksja Zgura e cila mori çertifikatën e kryerjes me sukses të Internshipit pranë kësaj Agjencie si dhe ftesën për punësim.

Trajnim: në ambjentet e Agjencisë Imobiliare CENTURY21 Action, me studentët e programit “Agjent i Pasurive të Paluajtshme” dhe “Asistent Juridik” zhvilluar në kuadër të njohjes së praktikës së punës dhe menaxhimit të procesit të shitjeve të pasurive të paluajtshme në vendin tonë me Broker të Zyrës Znj.Nertila Radomi.

Trajnim: "Huamarrje e Zgjuar dhe Kontratat me Institucionet e Microcreditit" me të ftuar Znj.Vjollca Muçaj PHD, Drejtoreshë e Departamentit të Riskut në Institutin Financiar "Agro&Social Fund".

Leksion online: live në Televizionin FAX NEWS me temë "COVID-19 dhe ndikimi në sistemin gjyqësor Britanik" me të ftuar: Gazetarin e mirënjohur dhe Juristin në Britaninë e Madhe Z.Kujtim Vani, Ish-Studenti i FD në KUW.

Leksion online me temë: “ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Organizimi, Funkionimi dhe Sfidat” me të ftuar Zv. Kryetari Këshillit Lartë të Prokurorisë Z. Alfred Balla.

Leksion online: me temë: "Drejtoria e shërbimeve të transportit rrugor dhe problematikat në kohë pandemie". me të ftuar Z. Kreshnik Tërnova Av, MPH, LL. M i cili është Drejtor Rajonal i Shërbimeve të Transportit Rrugor, Durrës.

Leksion online: "Tirana 100 vjet kryeqytet" me të ftuar Historianin, Drejtori Arkivit Qendrorë FA ne Ministrinë e Mbrojtjes Prof.Asoc.Dr.Teki Kurti dhe Historianin Prof.Asoc.Dr. Çlirim Duro.

Seminar online: "Diritto e Giustizia" me të ftuar Prof. Emeritus Sebastiano Tafaro Università degli Studi di Bari "Aldo Moro" si dhe pjesëmarrjen veçantë të Prof. Dr. Arta Mandro (Balili) Shkolla e Magjistraturës, dhe Ph.D. Shpëtim Karakushi, Prokuroria e Tiranës.

Leksion online: "Nasciturus pro iamnatohabetur – Diritto alla vita – Prospettive romane e moderne? me të ftuar Prof. Malina Novkirishka Univ. Sofies Bullgari, Presidente dell' Associazione dei Romanisti dei Balcani me pjesëmarrjen: Prof. Emeritus Sebastiano Tafaro Università degli Studi di Bari "Aldo Moro" .

Leksion online: "Il ruolo della vittima del reato nei procedimenti innanzi all' International Criminal Court. Il principio nullum crimen sine lege nella giurisprudenza delle Corti penali internazionali" të ftuar Prof. Pierpaolo Rivello Università di Torino Procuratore Generale militare emerito presso la Corte di Cassazione. Presidente della Commissione tributaria di Cuneo me pjesëmarrjen e Prof. emeritus Sebastiano Tafaro Università degli Studi di Bari "Aldo Moro".

Leksion online: " L'avvocato e la verità " të ftuar Avv. Vincenzo di Maggio - ex-presidente dell'ordine dei Avvocati di Taranto. Componente del: - Consiglio Nazionale Forense presso il Ministero della Giustizia; - della Scuola Superiore dell'Avvocatura; - della FIIF (La fondazione per la informatizzazione e l'innovazione forense) ku ndërroi me pjesëmarrjen: Prof. emeritus Sebastiano Tafaro Università degli Studi di Bari "Aldo Moro" , Prof. emeritus Kudret Çela

Universitet i Tiranës UT, Prof. Dr. Altin Shegani Ph.D. Universitet i Tiranës dhe Ph.D. Shpëtim Karakushi, Prokuroria e Tiranës.

Botime shkencore dhe Revista “Wisdom”: Përgjatë vitit akademik 2019-2020 NjKSH&MJ në FD bazuar në rregulloren, planin strategjik të KUW, nxit pedagogët, kërkuesit shkencorë dhe studentët duke i inkurajuar të botojnë libra, artikuj shkencorë. Revista WISDOM” botohet 2 (dy) herë në vit në formatin A4, me rreth 200 faqe. Pedagogët e brendshëm kanë përparësi në botimet e tyre, duke ruajtur kritere të rrepta shkencore dhe standarde akademike. Përgjithësisht, janë inkurajuar botimet shkencore, të cilat kanë trajtuar në mënyrë të veçantë një çështje apo dukuri me interes për fushat e studimeve në Kolegj. Punimet e Konferencës “Studime ndërkulturore në fushën e së drejtës, shkencave ekonomike dhe shoqërore”, më datë 9-10 Maj 2019, u botuan në librin Conference Proceedings ISBN 978-9928-4356-7-5, 9-10 Maj, 2019, Wisdom press, 2019. Punimet më të mira të diplomës të çdo viti akademik, të vlerësuara nga një komision akademik i ngritur nga dekani, paraqiten në një orë të hapur ose gjatë konferencave studentore.

Biblioteka: si pjesë e infrastrukturës shkencore të Kolegjit, i mundëson stafit akademik shfrytëzimin e një literature të pasur bashkëkohore (libra dhe revista akademike) të arkivuar ose në sistemet e bibliotekave elektronike. Ku ne kemi marrëveshje bashkepunimi me bibliotekat online si PROQUEST, COBISS, dhe disponojmë një numër të konsiderueshëm librash fizik.

Të dhëna tabelore përmbledhëse për përfshirjen e stafit dhe studentëve në aktivitetet e zhvilluara për vitin 2019-2020.

Përfshirja e projekteve	Leksione të hapura kombëtare	Leksione të hapura ndërkombëtare	Konferenca kombëtare/ndërkombëtare	Professor të ftuar	Përfshirja e studentëve në Trajnime/Mobilitet/ Konferenca
2	13	4	2/1	5	2

Ecuria e punës kërkimore shkencore e stafit akademik në FD.

KUW angazhon në kërkimin shkencor profesorë me tituj dhe grada si pjesë e personelit akademik, duke u kujdesur njëkohësisht që në këto proces të përfshije gradualisht me standartet e duhura brezin e ri të pedagogëve me synimin në rritjen dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre, Ndër indikatorët e kualifikimit akademik do të jenë: Gradat dhe titujt shkencore; Eksperiencën në fushën e mësimdhënies; Eksperiencën profesionale; Botime akademike; Kualifikimet ekstra kurrikulare; etj., NJSBC ka miratuar me vendim Nr. 218. dt25.05.2019, Formularin e vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike e kërkimore-shkencore, i cili është i detyrueshëm për t'u plotësuar në formë periodike, kryesisht një vjeçare (30 tetor 2020).

Në FD janë si pjesë e personelit akademik disa anëtarë të cilët janë në proces për marrjen e gradës shkencore Doktor, si psh Gerta Gjeta personel akademik efektiv (PAE), i angazhuar në mësimdhënie. Po ashtu lidhur me mobilitetin e stafit përmendet pedagogia Edit Bregu, e cila është mbështetur nga fondet e kërkimit shkencor për të qenë exchange profesor. Keta pedagogë kanë gjetur mbështetjen nga institucioni si nga ana financiare ashtu edhe nga shkëputja kohore e punës për të realizuar objektivat, pa ndalesa në detyrimet financiare të parashikuara në kontratë.

Gjithashtu, mbështetja është instaluar nga Vendimi i Administratores së Shoqërisë Wisdom, i cili parashikon një fond çdo fillim viti fizik për publikimet, zhvillimin dhe organizimin e ngjarjeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare për mobilitetin e stafit akademik dhe rritjen e tyre akademike. Një tjetër mbështetje nga institucioni është dhënia e mundësive të personelit akademik për të botuar pa detyrime financiare në Revisten Shkencore periodike "Wisdom", një botim i Wisdom Press, si edhe në publikimet e 'Conference Proceedings, për çdo konferencë të zhvilluar nga institucioni.

Aktivitete individuale të stafit akademik në FD viti akademik 2019-2020		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik	22
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara në shkallë Departamenti/Fakulteti	2

3.	Numri i projekteve të zbatuara në shkallë Departamenti/Fakulteti	2
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga Departamenti/Fakulteti dhe IAL	33
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore	7
6.	Numri i Çmimeve Kombëtare të fituara në rang IAL	0

d.3. Veprimtaria kërkimore-shkencore në FSHESH

Në përmbushje të objektivave të veta, NJKSH&MJ, në FSHESH, ka përmbushur objektivat e parashikuara në programin vjetor të veprimtarive Kërkimore Shkencore për vitin akademik 2019-2020. Gjatë vitit akademik 2019-2020 ka organizuar:

1. Leksione të hapura me profesorë të huaj: NJKSH&MJ në bashkëpunim me Departamentin e Ekonomisë, në kuadër të Programit “Visiting Professorship” organizuan kursin dy javore me profesorin e Ekonomisë, Ronald M. Nate, PhD nga Brigham Young University Idaho, SHBA. Tema e këtij kursi ishte “Principles of Microeconomy” dhe u ndoq kryesisht nga studentët e departamentit të ekonomisë. Kursi u zhvillua nga data 2/12/2020- 13/12/2020.

2. Konferenca: NJKSHMJ në bashkëpunim me Rrjetin për demokraci i Grave, WDN, Albania realizoj më 13/12/2020 konferencën “Steriotipet Gjimore në media” me mbështetjen e AMA-s. Në këtë konferencë referuan tre student të KUW.

3. Workshop: NJKSH&MJ në bashkëpunim me Departamentin e Ekonomisë, organizuan workshop dy ditor me profesorin e Ekonomisë, Ronald M.Nate, PhD nga Brigham Young University Idaho, SHBA. Workshop u zhvillua në datat 4 dhe 5 dhjetor 2020 me stafin pedagogjik për temat:

- An economics professor’s approach to teaching a difficult Subject
- Economic Freedom and Prosperity

Në kuadër të projektit Erasmus + ‘Cultural Studies in Business’ NJKSHMJ dhe IKZH Wisdom organizuan një workshop me studentë dhe lektore nga universitete të ndryshme private dhe

publike, të cilët u njohën me një nga rezultatet e këtij projekti, i cili është krijimi i një lënde pilot në departamentin e ekonomisë në KUW ‘Studime kulturore në biznes’, që do të implementohet në të gjithë vendet partnere.

NJKSHMJ në bashkëpunim me bashkëpunim me IKZH Wisdom më datë 01/11/2019 organizoi workshopin “Imazhet gjinore në media”, ku u diskutua mbi rëndësinë që ka etika e komunikimit mediatik në shoqëri dhe çështjen e barazisë gjinore.

NJKSHMJ në bashkëpunim me bashkëpunim me IKZH Wisdom më datë 21/11/2019, në kuadër të implementimit të projektit nga Qendra “Fokus” organizuan trajnimin me temë “Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve” Në këtë trajnim ishin të pranishëm përfaqësues të institucioneve shtetërore me profile jurist, psikolog si dhe pedagog të KUW.

NJKSH&MJ në bashkëpunim me RE/MAX INFINITY realizuan workshop me temë “Të njihemi me procesin e negocimit dhe marketingut në Real Estate” me trajnues Besard Rusi në datë 15/01/2020

4. Mobiliteti i stafit dhe studentëve: Në kuadër të implementimit të projektit Erasmus+ ref.No.2019-1- IT02-KA203-048091 “Cultural Studies in Business” NJKSH&MJ në bashkëpunim me Departamentin e Ekonomisë ka mundur pjesëmarrjen e tre pedagogëve në “Learning Mobility” në Portugali në nëntor 2019.

NJKSH&MJ në Bashkëpunim me Departamentin e Ekonomisë ka mundur pjesëmarrjen e tre studentëve nga programin Master Shkencor Administrim Biznesi dhe një student nga program “Menaxhim Biznesi” të ndjekin ëorkshopin 3-ditor në Kroaci me temë “Doing Business across cultures” në datat 13-16 Janar 2020.

Bazuar në rregulloren e NJKSH&MJ, mbi krijimin e lehtësirave të bashkëpunimit dhe përfshirjen e studentëve në trajnime, ëorkshope kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ndërkombëtare u krijua mundësia e përfshirjes së një studenti të departamentit të Ekonomisë trajnimin “Empoëring Youth Entrepreneurship”. Ky trajnim u organizua në kuadër të programit Erasmus + Youthpass. Trajnimi u zhvillua nga data 17/02/2020 deri në datën 25/02/2020 në Mostar, Bosnje Hercegovinë.

NJKSH&MJ krijoi mundësinë e përfshirjes së një studenteje të FSHESH në trajnimin "Gender based and sexual violence in love relationships of youngsters". Ky trajnim u organizua në kuadër të projektit YouthToo, pjesë e programit Erasmus +. Trajnimi u zhvillua nga data 20.02.2020 deri në datën 29.02.2020 në Bar, Mal i Zi. Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e kapacitetit të rinjve për të punuar në fushën e barazisë gjinore dhe dhunës në marrëdhëniet ndërpersonale.

6. Leksione të hapura

Departamenti i Ekonomisë në bashkëpunim me NJKSH&MJ organizuan një leksion të hapur "Studime ndërkulturore në Biznes" Dr. Enriko Ceko.

NJKSH&MJ në bashkëpunim me Departamentin e Ekonomisë të FSHESH organizoi javën dialektike. Java dialektike u zhvillua nga data 01.06.2020 deri më 05.06.2020 nëpërmjet platformës ZOOM.

Të ftuarit dhe temat e trajtuara përgjatë javës dialektike janë si më poshtë:


- Prof. Dr. Arben Malaj - Politikat monetare dhe fiskale gjatë dhe pas pandemisë
- Dokt. Marjeta Kodra - Problematikat e bursës në kohë pandemie rimëkëmbia
- Dr. Rajmonda Beluli - Tregu i punës gjatë pandemisë
- Dr. MBA. Enriko Ceko - Ku po shkojmë? Si të përballojmë situatën e Covid 19?
- Dokt. Jonida Myshketa - Fiskalizimi? A janë gati bizneset për këtë ndryshim të ri? Sfidat që na presin?
- Artan Gjergji (Drejtor i Bursës Shqiptare) - Arkitektura e Bursës dhe tregut të kapitaleve në shqipëri

NJKSH&MJ në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë të FSHESH organizoi javën dialektike. Java dialektike u zhvillua nga data 08.06.2020 deri më 12.06.2020 nëpërmjet platformës ZOOM. Qëllimi i javës dialektike ishte ndarja e ideve, analizave e opinioneve mbi situatën psiko-sociale të shkaktuar nga gjendja e pandemisë.


Të ftuarit dhe temat e trajtuara përgjatë javës dialektike janë si më poshtë:

- Dr. Anisa Subashi - Shërbimet sociale ndaj Covid-19
- Prof. Asoc. Dr. Erika Melonashi - Konjicioni, emocioni dhe sjellja: Cfarë na mësoi pandemia Covid-19?

- Prof.Asoc.Dr. Artemisi Shehu- Vetëvrasja në adoleshencë
- Msc.Anxhela Peza- Pedofilia incestuale
- Dr. Valbona Treska- Roli i Urdhrit të Psikologut në konsolidimin e profesionit të psikologut
- Prof.Asoc.Dr. Arjana Mucaj – Ndikimi dhe përjetimi psikologjik i izolimit nga pandemia në shoqërinë shqiptare
- Prof.Dr. Erleta Mato- Vlersimi psikosocial i projektit shkollor
- Dr. Edo Sherifi - Sfidat e shërbimit psikologjik shkollor




Grafik 1 Të dhëna mbi aktivitetet e organizuara nga NJKSH&MJ e FSHESH



Grafik 2 Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit akademik të departamentit të Psikologjisë

Botime në Revistën “Wisdom”: Përgjatë vitit akademik 2019-2020 është botuar revista shkencore periodike WISDOM Nr. 7. Në këtë revistë janë botuar katër artikuj nga stafi akademik i Departamentit të Psikologjisë dhe një artikull nga stafi akademik i Departamentit të Ekonomisë. Stafi akademik i Departamentit të Ekonomisë, Departamentit të Psikologjisë dhe departamentit të NJKSH&MJ të FSHESH ka plotësuar formularin e kërkimit shkencor, të miratuar nga NJSBC. Të dhënat nga formulari i kërkimit shkencor pasqyrohen në grafikët e mëposhtëm.



Grafik 3 Të dhëna mbi kërkimin shkencor të personelit akademik të departamentit të Ekonomisë

V. Vlerësime të institucionit mbi sigurimin e cilësisë dhe rekomandime

Institucioni ynë ndodhet në fazën e zhvillimit të mëtejshëm dhe konsolidimit të standardeve dhe mekanizmave ekzistuese të cilësisë në kuadër hapësirës mbarë evropiane të Arsimit të Lartë por edhe të përafrimit të politikave dhe strategjive të reja në lidhje me kriteret e cilësisë. Fenomeni i cilësisë në KUW, i pranishëm, mund të grupohet në disa procese, që kanë karakterizuar politikën e cilësisë së ndjekur gjatë vitit akademik 2019-2020 nga institucioni ynë ku mund të veçojmë:

- a. Aktivitetet e mësimdhënies;
- b. Aktivitete të karakterit kërkimor-shkencor;
- c. Performanca e studentit;
- d. Marrëdhëniet me jashtë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- e. Proceset administrative dhe ndihmëse;
- f. Akreditimi periodik institucional dhe procese të tjera akredituese në nivel programor.
 - a. Për sa i përket *elementit të mësimdhënies*, janë konsoliduar përpjekjet për zhvillimin cilësor të leksioneve dhe seminareve *online* dhe shfrytëzimi i *portalit të studentit* në një atmosferë sa më bashkëkohore, ku padyshim teknologjia si dhe metodat e adoptuara luajnë një rol parësor.

Gjatë vitit akademik 2019-2020, KUW përmbushi synimet e planifikuara, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe veprmtaritë kërkimore-shkencore. Ky vit akademik është shoqëruar nga vështirësi të krijuara në rrethanat e gjendjes së pandemisë si rezultat i përhapjes së virusit COVID-19. Menjëherë pas daljes së Urdhërit Nr. 91, datë 09.03.2020 me Nr. 1867 Prot. të Ministres së MASR “*Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike*”, për parandalimin e përhapjes së COVID-19, autoritetet drejtuese të KUW morën masat organizative teknike dhe realizuan me sukses vazhdimin rregullt të procesit mësimor akademik, shpërndarjen e plotë të informacionit lëndor nga çdo pedagog, sipas lëndëve përkatëse, nëpërmjet kanaleve online dhe *Portalit të Studentit*, në web-in zyrtar www.wisdom.edu.al tek të gjithë studentët që ndoqën studimet në KUW përgjatë vitit akademik 2019-2020. Përgjithësisht sipas rezultateve të anketimeve, vihet re aplikimi i metodave të

mësimdhënies interaktive kanë ndikuar në një pjesëmarrje sa më të gjerë të studentëve. Vënia në praktikë e dijeve të përftuara nga studentët është projektuar si prioriteti kryesor. Për këtë arsye në procesin e mësimdhënies (online gjatë Sem II) janë ofruar personalitete të rëndësishëm në fushat e drejtësisë, ekonomisë dhe psikologjisë, të cilët ju kanë ofruar eksperiencën e tyre praktike studentëve duke i sjellë studentët më pranë nevojave praktike të tregut të punës si dhe duke garantuar cilësi të dijeve të marra në Kolegjin tonë.

- b. Në lidhje me elementin e *aktiviteteve kërkimore-shkencore*, ka pasur një politikë konstante në lidhje me zhvillimin dhe zgjerimin e hapësirave kërkimore shkencore brenda institucionit tonë.

Krahas strategjisë së përgjithshme të kërkimit shkencor në IAL, facilitete dhe impute të tilla si p.sh biblioteka, pasurimi i saj me librat më bashkëkohore, biblioteka online, interneti, prania e vazhdueshme e lektorëve të huaj, kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen e aksesit të pedagogëve ndaj zhvillimeve më të fundit në plan kombëtar dhe ndërkombëtar mbi fushat e tyre të studimit. Biblioteka e KUW është pjesë e sistemit kombëtar bibliografik COBISS.AL. Ajo përfaqësohet gjithashtu në Bibliotekën Virtuale të Shqipërisë COBIB.AL. Biblioteka online ProQuest u ofron të gjithë anëtarëve të Bibliotekës mundësinë e të lexuarit, të studiuarit, dhe të eksploruarit online sipas interesave të tyre të studimit. Aktualisht Biblioteka elektronike ofron përkatësisht 180.716 tituj total libra online akademik, në format PDF, si: Law, Philosophy, Business, Literature, English dhe janë të aksesueshme, për studentë e stafin akademik. Po kështu është adoptuar përmes një politike të qëndrueshme pasurimi i silabuseve me literaturë relevante vendase dhe të huaj, por pavarësisht arritjeve, institucioni është i përgjegjshëm për nivelin e sfidave të pritshme dhe për të cilat kërkohet hartimi i strategjive të qarta dhe të qëndrueshme.

- c. Në lidhje me *performancën e studentëve* është adoptuar formula që siguron një zhvillim të vazhdueshëm të performancës së studentit, si dhe rritje të cilësisë së bashkëveprimit student – pedagog.

I gjithë personli akademik angazhohet në procesin e integritit të rezultateve të punës së tyre kërkimore- shkencore në procesin mësimor (leksione, seminare, monografi shkencore etj.) Për

këtë qëllim, të organizohen seminare dhe tryeza diskutimesh akademike, me pjesëmarrjen e përbashkët të personelit akademik dhe studentëve. Në këto veprimtari anëtarët e personelit akademik të përditësojnë njohuritë e studentëve me të rejat nga veprimtaria e tyre hulumtuese dhe ndihmojnë në mjeshtërimin e kompetencave në përputhje me fushat e ekspertizës. Performanca e studentëve gjatë këtij viti akademik është realizuar përmes vënies në funksionim të mekanizmave monitorues dhe rezultatet e arritura janë të përmendura edhe më sipër në këtë raport.

- d. Për sa i përket këndvështrimit të *marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve me jashtë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar*, mund të cilësojmë se KUW po zhvillon përpjekjet e tij për shtrirjen e projekteve të bashkëpunimit dhe anëtarësimit me IAL brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunimi me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, angazhime në projekte të ndryshme në fushën e arsimit universitar, zgjerimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani të mirënjohura biznesi, institucione dhe sektorë të administratës publike e etj.,

Aktualisht regjistrohen 108 marrëveshje bashkëpunimi, binjakëzime dhe memorandume mirëkuptimi në nivel institucional, me shkolla të larta universitare, akademi, kompani private, studiologjore, institucione shtetërore, organizata jofitimprurëse dhe shoqata të ndryshme. Gjatë vitit akademik 2019-2020 përpjekjet për zhvillimin e marrëdhënieve me jashtë të institucionit tonë i kemi parë të përqendruara në disa fusha që janë:

1. Përafrimi i programeve të lëndëve me standardet e universiteteve të ndryshme perëndimore;
2. Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL të ndryshme (kryesisht ato perëndimore) dhe qendra kërkimore apo institute të kërkimit shkencor;
3. Shkëmbimi i përvojave në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
4. Nxitja e punës kërkimore tek stafi dhe mbështetja e stafit për punën kërkimore dhe sigurimi i pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivitete ndërkombëtare shkencore, konferenca ndërkombëtare shkencore, botime në revista me faktor impakti etj;

5. Bërjen të mundur të zhvillimit të aktiviteteve online, (konferenca shkencore, leksione të hapura, seminare etj) në kuadër të përshtatjes me gjendjen dhe kufizimet e aktiviteteve fizikisht në auditore, të shkaktuar nga Covid-19.

e. Në lidhje me *proceset administrative e ndihmëse*, mund të thuhet se nga pikëpamja administrative e procesit të cilësisë, i është vënë theksi zhvillimeve të vazhdueshme me qëllim evidentimin e IAL tonë si një IAL elitare dhe e konsoliduar në vend.

f. Akreditimi periodik Institucional si dhe akreditime të tjera programore përgjatë vitit akademik 2019-2020. Përgjatë vitit akademik 2019 – 2020 në KUW u realizua procesi i akreditimit periodik institucional. Vlen të theksohet se IAL- ynë e ka vlerësuar maksimalisht këtë proces duke e trajtuar me seriozitet si dhe duke marrë të gjitha hapat e duhura për mbarëvajtjen e procesit por edhe dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar brenda të gjitha afateve të parashikuara në Legjislacionin për Arsimin e Lartë në RSH. Gjatë vitit akademik 2020-2021 në KUW do të realizohen proceset akredituese të programeve: Master i Shkencave në Psikologji Shkollore dhe Edukimi si dhe Programi i studimit me karakter profesional Asistent Administrativ.

Për sa i përket *këndvështrimit tonë*, gjykojmë që disa prioritete duhet të mbahen nën një konsideratë të vazhdueshme:

- Duhet të përmirësohen linjat e komunikimit, si në aspektin e personelit akademik me njëri-tjetrin ashtu edhe ndërmjet këtyre të fundit të studentëve duke marrë në konsideratë edhe periudhën gjatë së cilës do të jemi online si rezultat i pandemisë gjatë këtij viti akademik;
- Duhet të nxitet pjesëmarrja e personelit akademik në sa më shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare apo aktivitete të tjera të karakterit shkencor me qëllim që praktika e marrë nga stafi të shërbejë në nxitjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit të mësimdhënies;
- Duhet të nxitet pjesëmarrja e personelit akademik dhe studentëve në sa më shumë projekte ndërkombëtare me qëllim rritjen e mobilitetit të pedagogëve dhe studentëve;

- Duhet të nxitet angazhimi i personelit akademik në botime shkencore në revista ndërkombëtare të indeksuara me faktor impakti;
- Nga të dhënat e evidentuara Institucioni duhet të punojë me rritjen dhe larmishmërinë e aktiviteteve mësimore dhe jashtë-mësimore që do të ndikojnë në rritjen e nivelit të frekuentimit në leksione dhe seminare;

NjsBC bazuar në Legjislacionin për arsimin e lartë në vend, standartet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë (SUE), aktet rregullatore të miratuara në institucion, etj si dhe në Kodin e cilësisë së arsimit të lartë të miratuar me VKM Nr.531 datë 11.09.2018, do të punojë në vazhdimësi referuar kritereve të përcaktuara në të duke dhënë mendime, propozime me qëllim zhvillimin e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë në KUW.

Gjykojmë që mirëpritja dhe diskutimi i këtyre prioritetëve do të ishte thelbësor në zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të cilësisë në të gjitha organet IAL-së.

Hartoi,

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

1. Dr. Edit BREGU
2. Msc. Loreta ÇIÇO
3. Msc Flavia KENAJ
4. Msc. Klevisa MUÇA
5. Desada MINXOLLI (*studente*)

Tiranë më, Nëntor 2020.

